



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK
DHE RAPORTIMIT FINANCIAR
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 11267 Prot.

Tiranë, më 23. 7. 2025

URDHËR

Nr. 103, Datë 23.7. 2025

PËR

**“MIRATIMIN E STANDARDEVE GLOBALE TË AUDITIMIT TË
BRENDSHËM TË PRANUARA PËR ZBATIM NË SEKTORIN PUBLIK NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, germës a) të nenit 8 të ligjit nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik dhe Raportimit Financiar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Standardeve Globale të Auditimit të Brendshëm, të pranuar për zbatim në sektorin publik në Republikën e Shqipërisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri.
2. Urdhri nr.40, datë 08.05.2017 “Për publikimin e standardeve ndërkombëtare për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm në sektorin publik të pranuar për zbatim në Republikën e Shqipërisë”, shfuqizohet.
3. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet struktura përgjegjëse e harmonizimit për auditimin e brendshëm në ministrinë përgjegjëse për financat, si dhe të gjitha njësitë e auditimit të brendshëm në sektorin publik.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Petrit Malaj

